



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIMIT
SHKOLLA E MESME PROFESIONALE "KOLE MARGJINI" SHKODER

Nr. 201 Prot.

Shkoder më 08.11.2022

Lënda : Njoftim për vend të lire pune.

Drejtuar: AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIMIT,
Tiranë

Në zbatim të Ligjit Nr. 15/2019 "Për nxitjen e Punësimit", Ligjit nr. 15/2017 datë 16/02/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.554, datë 31.07.2019 "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive", Neni 19 të Udhëzimit nr. 11, datë 3.3.2020 "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional", Urdhërit nr.172, datë 24.12.2019 "Për miratimin e strukture dhe organikës së Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive" profesional'si dhe Udhëzimin nr.28, datë 14.10.2019. "Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit profesional "

Ju njoftojme për dy vend të lira në pozicionin e mesimdhënies në teorinë profesionale, drejtimi mësimor dega pyje (Inxhinjer Pyjesh) Shkolla Teknike Pyjore "KOLE MARGJINI" SHKODER

Mësimdhënie të kulturës profesionale në ofruesit të AFP-së duhet të përmbushë këto kritere:

1. Kriteretë përgjithshme:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit
- f) të demonstrojë aftësitë punës në grup dhe motivimit

2..Kritere të posaçme për personelin mësimdhënës të formimit teorise profesionale në ofruesit e AFP-së, që ofrojnë arsim profesional:

a) të ketë diplomë të nivelit master profesional ose të barazvlefshëm në të njëjtën fushë, që lidhet me kualifikimet profesionale të ofruesit të AFP-së;

b) të ketë të paktën 1 (një) vit përvojë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet;

c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit.

Dokumentat e aplikimit

Dosja e aplikimit e cila përmban dokumentacionin e kërkuar sipas njoftimit të vendit të lire duhet të përfshijë:

-Letermotivim për pozicionin

-Jetëshkrimin (CV)

-Karte identiteti

-Diplomen

-Librezen e punës

-Cdo dokumentacion që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV

-Certifikat ose dëshmi për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit.

-Vërtetim i gjendjes shëndetësore

-Vërtetimin e gjendjes gjyqësore

-Vërtetim nga punëdhënësi i fundit, që ndaj tij nuk janë marrë masë disiplinore të cilat sjellin në fuqi

-të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

Të gjitha dokumentat të jenë origjinale ose të noterizuara, dokumentat në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer dhe noterizuara,

Dokumentat e aplikimit dorëzohen në protokollin e ofruesit të AFP –se deri më datë 16.11.2022

Drejtori

Albana Llesha

